

AKT THEMELIMI
i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar
“Alteco Technologies & Communication” SH.P.K.

Sot, me 18.05.2023, ne te nenshkruarit: Helga Çaçani e datelindjes 14.09.1995 e pajisur me pasaporten biometrike J55914065T, Alexis, Gabriel Murat i datelindjes 14.02.2000 i pajisur me pasaporten franceze me numer 18FI65136, Yann Murat i datelindjes 20.05.1968 i pajisur me karte identiteti franceze me numer 160131304074, regjistrojme nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar me emrin “Alteco Technologies & Communication” Sh.p.k.

Neni 1

Personat e siperpermendur, me vullnetin e tyre te lire dhe te plote dhe ne perputhje me legjislacionin Shqiptar ne fuqi, vendosen te krijojne Shoqerine me Pergjegjesi te Kufizuar me emertimin “Alteco Technologies & Communication” Sh.p.k., me kapital themeltar 10 000 Leke.

Selia e shoqerise ndodhet ne Tirane ne adresen: Njesia Bashkiake Nr. 7, Rruga Bedri Karapici, Kompleksi Golden Park, Seksioni 2, Zyra 10.

Ortaket e kesaj shoqerie do te jene: Helga Çaçani, Alexis, Gabriel Murat, Yann Murat.

Shoqeria “Alteco Technologies & Communication” Sh.p.k., ka te drejte te krijojte filiale brenda dhe jashte Shqiperise, ne menytrat dhe me kohezgjatje ashtu sikunder e konsideron te arsyeshme, dhe me miratimin e organeve kompetente.

Neni 2

Kompania gazon statusin e personit juridik.

Aktivitetet e saj do te kryhen sipas dispozitave te ketij akti, statutit dhe legjislacionit aktual. Statuti i kompanise eshte i bashkelidhur ketij akti te themelimit dhe formon nje pjese integrale me te.

Neni 3

Veprimtaria e kompanise si nje entitet juridik fillon me miratimin e krijimit te saj nga ana e organeve kompetente te shtetit dhe do te jete e vlefshme per nje periudhe te pacaktuar kohe.

Shoqeria perfundon aktivitetet e veta me vendimarrje unanime nga te gjithe ortaket e saj.



Neni 4

Objekti i shoqërisë : Shoqëria organizohet dhe funksionon duke ushtruar veprimtarinë e saj në fushën e Marketimit Digital dhe aktiviteteve të tjera që lidhen indirekt me këtë fushë, me objekt të detajuar:

- Ndërtimi dhe programim i faqeve të internetit informative. Prodhimi i faqeve dhe shitblerjeve online.
- Konsulenca marketimi dhe analiza tregu për biznesin.
- Menaxhim dhe krijim i rrjeteve sociale, krijimi i strategjive të marketingut.
- Konceptimi dhe krijimi i markave për një biznes të caktuar.
- Krijimi i spoteve dhe reklamave televizive dhe për rrjetet sociale.
- Prodhimi i fotografive dhe materialeve filmike.
- Dizajni dhe konceptim grafik, krijimi i banerave dhe fotografive me logo.
- Analiza tregu dhe analiza e ecurisë së biznesit.
- Bashkëpunimi për rritjen e audiencës së blogereve, personazheve me influencë dhe personazheve të njohur të botës së televizionit, politikës, artit, modelingut, kinematografisë së huaj dhe shqiptare, etj.
- Krijimi i artikujve dhe shkrimeve për portale online dhe rrjetet sociale.
- Menaxhimi i buxhetit për reklamimin e biznesit online në rrjetet sociale dhe në Google.
- Optimizimi i motoreve të kërkimit në Google (SEO)
- Gjenerimi i të ardhurave nga faqet e internetit.
- Raportimi dhe analiza e faqes online.
- Instalimi dhe krijimi i rroboteve asistent online (Chatboot)
- Krijimi i strategjisë, krijimi i emaileve kontaktues dhe dërgimi i emaileve kontaktues (email marketing)
- Krijimi i bazës së të dhënave me klientet potencial të një biznesi për qëllime marketimi.
- Ofrimi i kurseve dhe trajnimeve për menaxhimin e punëve online dhe rrjeteve sociale.
- Ofrimi i trajnimeve të lidershit dhe rritjes së influencës online.
- Ofrimi i kurseve për dizajnim grafik.
- Import i makinerive edhe pajisjeve të nevojshme për realizimin e aktiviteteve të marra për siper nga kompania.
- Instalime teknike të rrjeteve të internetit.

Çdo lloj aktiviteti tjetër të lidhur me sa më sipër, vetë me burimet e saj njerëzore apo me ndihmën dhe mbështetjen e të tretëve, persona fizikë apo juridikë qofshin, vendas apo të huaj.

Handwritten signature

Handwritten signature

Handwritten signature

Shoqëria mund të lidhë kontrata, përsa është përcaktuar në paragrafet prezent dhe për aktivitete të tjera që mund të jenë aktivitete plotësuese dhe ndihmëse, për një shfrytëzim më të plotë të aftësive të shoqërisë, dhe ku ajo vetë e sheh me leverdishmëri për zhvillimin dhe pasurinë e saj.

Ajo mund të financojë për asistencë teknike, ekspertë, vendas apo të huaj, për kryerjen e studimeve tërësore tekniko-profesionale, marketingu, menaxheriale, për zhvillimin e vetë shoqërisë.

Shoqëria është e autorizuar dhe ka të drejtë të ushtrojë veprimtarinë e saj në mënyrë të pakufizuar, më kufij të që e lejon ligji dhe të përfshihen në sferën dhe natyrën juridiko-profesionale të shoqërisë.

Shoqëria mund të bashkëpunojë dhe të marrë interesa, në shoqëri, agjensi dhe ndërmarrje, të cilat mund të kenë edhe qëllime të tjera aktiviteti. Për realizimin e objektit dhe qëllimeve të saj, Shoqëria mund të ndërmarrë dhe zhvillojë çdo lloj operacioni financiar të konsideruar të dobishëm dhe të përshtatshëm për qëllimet e saj.

Gjithashtu Shoqëria mund të lerë garanci, hipotekë në favor të ndonjë banke, instituti krediti apo çfarëdolloj instituti financiar. Shoqëria mund të zhvillojë këto shërbime si direkt ashtu edhe nëpërmjet konsulentëve apo të tretëve.

Në përputhje me legjislacionin shqiptar, Shoqëria mund:

- a. Të kryejë çdo transaksion në lidhje me pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme, si dhe çdo aktivitet tregtar, financiar, dhënie marrje me qera, aktivitete këto të konsideruara si të dobishme apo të nevojshme për të arritur qëllimet e Shoqërisë dhe që nuk tejkalojnë në masë aktivitetet kryesore, të cituara më sipër;
- b. Të ofrojë asistencë në fushën e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, si dhe të kryejë aktivitete publikimi dhe reklamimi.

Objekti i Shoqërisë mund të ndryshohet ose shtohet në përputhje me dispozitat ligjore.

Për realizimin e qëllimit të mësipërm shoqëria ka të drejtë:

- t'ju besojë të tretëve pjesë të punimeve të produkteve të saj ose shërbimeve;
- të përfundojë kontrata agjensie me ose pa përfaqësim, me qëllim që të promovojë për llogari të palës tjetër ose të promovohet nga pala tjetër për llogari të saj, aktivitete dhe prodhimet e mësipërme, duke përfshirë të gjitha aktivitete e ndërmjetësimi të çfarëdo fushe;
- gjetjen e stabilimenteve për ti ngritur, transformuar ose riaktivizuar;
- të operojë si në territorin kombëtar dhe jashtë tij, si dhe të përfundojë veprimtari importi dhe eksporti me qëllim realizimin e objektit të saj;
- Shoqëria mundet gjithashtu të realizojë të gjitha veprimtari industriale, tregtare, mobiliare, imobiliare dhe financiare që do të konsiderohen nga ortakët apo nga organi Administrativ të nevojshme ose të dobishme për arritjen e objektivit të shoqërisë, përfshirë këtu lëshimin e fidejusioneve dhe garancive të tjera reale ose personale si në favor dhe për llogari të të tretëve edhe me titull të garantuar;

- Shoqëria mundet gjithashtu të realizojë të gjitha veprimtaritë e ndërmjetësimit industrial, tregtar, mobiliar, imobiliar dhe financiar që do të konsiderohen të nevojshme dhe/ose të dobishme nga ortakët për arritjen e objektivit të shoqërisë, përfshirë këtu lëshimin e fidejusioneve dhe garancive të tjera reale ose personale si në favor dhe për llogari të të tretëve edhe me titull të garantuar. Shoqëria mund të blejë lirisht kuota apo aksione të shoqërive të tjera, vendase dhe të huaja.

Neni 5

Kapitali fillestar i kompanise do te jete 10 000 leke te ndare ne 3 kuota ku:

Helga Çaçani zoteron 1 kuote qe perfaqeson 40% te kapitalit me vlere 4 000 leke.

Alexis, Gabriel Murat zoteron 1 kuote qe perfaqeson 20% te kapitalit me vlere 2 000 leke.

Yann Murat zoteron 1 kuote qe perfaqeson 40% te kapitalit me vlere 4 000 leke.

Kapitali themelor eshte depozituar nga ortakët ne emer te shoqerise. Aktiviteti i shoqerise do te rregullohet, pervec ketij akti themelimi, me normat e vendosura ne Statut, kundrejt nenshkrimet te ortakeve, dhe aprovimit nga Qendra Kombetare e Regjistrimit, ditën qe do te marre cilesine e personit juridik.

Neni 6

Fitimi neto qe do te realizohet nga aktivitetet e kompanise do te ndahet midis ortakeve ne perpjesetim me aksionet e tyre ne kompani. Çdo anetar eshte i lire per te marre pjesen e vet te fitimeve ne nje llogari bankare brenda apo jashte shtetit Shqiptar.

Neni 7

Per borxhet qe mund te ezistojne ne te ardhmen ndaj paleve te treta gjate aktivitetit, shoqeria do te pergjigjet vetem me kapitalin e saj themeltar. Anetaret nuk jane pergjegjes per borxhet e shoqerise me pronen e tyre.

Neni 8

Anetaret jane te detyruar per te ruajtur natyren konfidenciale te aktivitetit te shoqerise.

Neni 9

Marredheniet e punes ne shoqeri apo deget e saj rregullohen me kontraten e punes ne lokalitetin e tyre dhe ne menyren e percaktuar nga ana e shteteve perkatese.

Neni 10

Rregullime me te detajuara mbi organizimin e kesaj shoqerie jane te percaktuara ne Statutin e saj. Themeluesi pas leximit me kujdes te Aktit te Themelimit e nenshkruan si te sakte dhe ne perputhje me vullnetin e tij.

Ortaket Themelues:

HELGA ÇAÇANI

ALEXIS,GABRIEL MURAT

YANN MURAT

Three handwritten signatures are present. The top signature is in black ink and appears to be 'Helga C'. The middle signature is also in black ink and is more stylized. The bottom signature is in blue ink and is also stylized.